

## VENDIM

Nr. 654, date 18.12.2002

### PER PERCAKTIMIN E TARIFAVE PER PERDORIM TE PERKOHSEM NGA ORGANET SHTETERORE, NE SITUATA EMERGJENTE, TE ÇDO MJETI PRIVAT

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutës, te neneve 3 pika 2, 31, pikat 1 e 2 te ligjit nr . 8756, date 26.3.2001 "Për emergjencat civile" dhe te nenit 37 te ligjit nr. 8766, date 5.4.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin" , me propozimin e Ministrit te Pushtetit Vendor dhe te Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

#### V E N D O S I:

1. Përcaktimin e tarifave për përdorim te përkohshëm nga organet shtetërore, ne situata emergjente, te çdo mjeti privat, si me poshtë vijon:

a) Strukturat operative te emergjencave civile, ne situata emergjente, kane te drejte te marrin ne përdorim te përkohshëm çdo mjet privat, kundrejt pagesës, sipas tarifave te përcaktuara ne shtojcën, qe i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Për mjetet e tjera, qe nuk janë përmendur ne këtë shtojce, llogaritjet te bëhen sipas fuqisë dhe tonazhit te tyre.

Llogaria behet duke shumëzuar vlerën ne tabelle me koeficientin  $k= 1,2$  kur fuqia/tonazhi është me e/i madh dhe e kundërta. Për mjetet e transportit e materialeve te përdoret tabela për ton/km, kurse për mjetet stacionare fuqia ne kw.

c) Kur strukturat operative te emergjencave civile, për mjetet qe marrin ne dispozicion, përballojnë karburantin nga rezervat e veta, atehere tarifa llogaritet ne baze te orëve te punës për manovratorin, plus konsumin e pjesëve te ndërrimit (ne rast konsumi), plus 10 për qind, si me poshte vijon:

$T=(m+0,2m)+10\%$ ; ku T -tarifa; m -pagesa për një ore pune për manovratorin. Koeficienti  $m= 120$  deri 160 leke, ne varësi te tonazhit/fuqisë se mjetit. Kufiri minimal për tonazhin/fuqinë me te ulet dhe e kundërta.

ç) Kur merren mjete ne dispozicion për transportin e udhëtareve, si: autobusë, mikrobusë, etj. tarifet janë te njëjta me ato te udhëzimit te përbashkët nr. 373/1, date 24.3. 1998 te Ministrisë se Punëve Publike dhe Transportit dhe nr. 99/3, date 24.3.1998 te Ministrisë se Financave.

2. Mjetet merren ne përdorim te përkohshëm, sipas aktmarrëveshjes se lidhur ndërmjet drejtuesve te operacionit ose përfaqësuesve te autorizuar prej tyre, për përballimin e situatave emergjente, për aq kohe sa është e domosdoshme, por jo me vone sesa koha e përfundimit te emergjencës.

3. Shpenzimet qe rezultojnë nga përdorimi i përkohshëm i mjeteve private, ne raste te situatave emergjente, te përballohen nga burimet financiare te institucionit, te siguruar ne përputhje me legjisllacionin ne fuqi.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KR YEMINISTRI

Fatos Nano

## SHTOJCA

### TARIFAT PER MJETET TRANSPORTUESE VETELEVI ZESE

Nr Largësia e transportit Km Ton/km Ne leke

- 1 Transporti deri ne 0.2 -:- 40
- 2 Transporti deri ne 0.5 -:- 30
- 3 Transporti deri ne 1 -:- 25
- 4 Transporti deri ne 2 -:- 22
- 5 Transporti deri ne 3 -:- 20
- 6 Transporti deri ne 4 -:- 18
- 7 Transporti deri ne 5 -:- 17
- 8 Transporti deri ne 6 -:- 16
- 9 Transporti deri ne 7 -:- 15
- 10 Transporti deri ne 8 -:- 14.5
- 11 Transporti deri ne 9 -:- 14
- 12 Transporti deri ne 10 -:- 12.8
- 13 Transporti mbi 10 -:- 12
- 14 Autoambulance 1.5 -:- 20
- 15 Sheverlet 1.5 -:- 15

### TARIFAT PER MJETET NGRIT ESE

Nr Emërtimi i mjetit ngritës Aftësia ngritëse ne Ton Lek/ore

- 1 Autovinç 1.5 890
- 2 Autovinç 5 1500
- 3 Autovinç 8 1750
- 4 Autovinç 10 1900
- 5 Autovinç 16 2100
- 6 Autovinç 20 3000
- 7 Autovinç Mbi 20 3500

### MJETE GERMIMI

Nr. Emërtimi mjetit Njësia matëse Kapaciteti 1 ore/pune Ne leke

- 1 Fadrome "UNK 320" - -:- 4500
- 2 Buldozer DT - 54 - -:- 1408
- 3 Buldozer DT \_75 - -:- 1502
- 4 Buldozer S 80-100 - -:- 2203
- 5 Buldozer S-150 - -:- 2890
- 6 Buldozer S -350 HP - -:- 3426
- 7 Ekskavator M3 0.15 -:- 1220
- 8 Ekskavator M3 0.25 -:- 1391

9	Ekskavator M3 0.35 -:-	1409
10	Ekskavator Varinski M3 0.4 -:-	1511
11	Ekskavator Varinski M3 0.5 -:-	2225
12	Ekskavator Varinski M3 1-1.25 -:-	2673
13	Ekskavator Varinski M3 2 -:-	3567
14	Fadrome Volvo - -:-	3607
15	Motopompe "Gaz 51" L/min -:-	1500
16	Motokompresor M3/sek -:-	2000
17	Motogjenerator Kw 40 -:-	2000
18	Motogjenerator Kw 68 -:-	2500
19	Zjarrfikëse ton 9 -:-	3500